

## Të drejtat e njeriut në Kosovë

### I. Hyrje

Njohja e dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë, meqë mosrespektimi dhe përbuzja e të drejtave të njeriut qon drejt veprimeve barbare, që fyen lirinë e fjalës, ndërgjegjen njerëzore, dhe meqë krijimi i një bote në të cilën njerëzit do të gëzojnë lirinë e fjalës, lirinë e besimit dhe lirinë nga frika dhe skamja është shpallur si aspiratë më e lartë e çdo njeriu.<sup>1</sup> Të gjithë popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes, ata përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe sigurojnë në liri zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor.<sup>2</sup> Dhe , përmes këtij hulumtimi do të analizojmë se sa respektohen te drejtat e njeriut në Kosovë, te drejta këto që i gëzon çdo qytetar i botes në mënyrë universale.

### II. Sfidat e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë

Kosova është pjesë e Evropës. Evropa është bashkësi e vlerave dhe parimeve të përbashkëta të bazuara në të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit, demokracinë, të drejtat e pakicave dhe marrëdhëniet ndëretnike të respektuara. Në një gjendje të pas konfliktit siç është Kosova, respektimi i këtyre parimeve është qenësor për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Ato definojnë standardet që mundësojnë matjen e progresit dhe janë të parashtruara në një sërë dokumentesh ndërkombëtare për të cilat është arritur pajtim nga organizatat ndërkombëtare.<sup>3</sup> Edhe pse Kosova, ka mekanizma ligjorë dhe institucionalë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, ato vazhdojnë të mos zbatohen në masë të duhur në terren. Kjo gjendje ka ardhur për shkak të jo

---

<sup>1</sup>DeklartaUniverzale për të drejtat e njeriut Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezoluten e saj 217 A (III) të dates 10 dhjetor ( 1948) : NewYork Human Rights SupportProgramme . Faqe 4.

<sup>2</sup>Pakti Ndërkombetar për të Drejtat Civile dhe politike : Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezoluten 2200A ( XXI ) , të dates 16 dhjetor ( 1996) NewYork: Human RightsSupport Programe. Faqe 5.

<sup>3</sup>Të drejtat e njeriut, marrëdhëniet etnike dhe demokracia në Kosovë. Verë- 2007 -

2008.<http://www.osce.org/sq/kosovo/33283> Prishtinë faqe 1

efikasitetit të mekanizmave ekzistues si dhe mosangazhimi i mjaftueshëm prej institucioneve publike në zbatimin e ligjeve që janë në fuqi.<sup>4</sup>

Ndër problemet më të rëndësishme të të drejtave të njeriut përfshihen barrikatat e vendosura në pjesën veriore të vendit nga ekstremistët serbë të Kosovës, duke kufizuar kështu të drejtat themelore, duke përfshirë lirinë e lëvizjes dhe qarkullimin e mallrave.<sup>5</sup> Fusha tjetër e shqetësimit serioz është diskriminimi shoqëror ndaj bashkësive pakicë që përballen me: diskriminimin zyrtar dhe shoqëror. Komuniteti serbë, romë, ashkali dhe egjiptian diskriminohen në punësim, arsim, shërbime sociale, përdorimin e gjuhës si dhe të drejtave të tjera themelore, anipse këto të drejta janë të garantuara me ligj.<sup>6</sup>

Problematik tjetër në raport me të drejtat e njeriut janë edhe korrupsioni, favorizimi në burgje, joefektiviteti i gjyqësorisë, paraburgimi i gjatë etj.<sup>7</sup> Me shkelje të drejtave përballen dhe personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e tyre. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efektive ligjet dhe programet për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në ndërtesa, informata dhe komunikim.<sup>8</sup>

Dhuna në familje ndaj femrave, duke përfshirë abuzimin bashkëshortor, është problem serioz dhe i vazhdueshëm. Ligji ndalon dhunën në familje dhe parasheh dënime me burg prej 6 muaj deri në 5 vjet.<sup>9</sup> Sipas prokurorisë speciale, besnikëritë familjare, varfëria, dhe numri i rasteve të grumbulluara në gjykatat civile dhe penale i kontribuan shkallës së ulët të ndjekjes penale.<sup>10</sup>

---

<sup>4</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012\\_hrr\\_kos\\_alb\\_raporti\\_i\\_vitit\\_2012\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_ne\\_Kosove\\_Prill\\_2012\\_Prishtine\\_faqe\\_2](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012_hrr_kos_alb_raporti_i_vitit_2012_mbi_te_drejtat_e_njeriut_ne_Kosove_Prill_2012_Prishtine_faqe_2).

<sup>5</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012\\_hrr\\_kos\\_alb\\_raporti\\_i\\_vitit\\_2012\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_ne\\_Kosove\\_Prill\\_2012\\_Prishtine\\_faqe\\_2](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012_hrr_kos_alb_raporti_i_vitit_2012_mbi_te_drejtat_e_njeriut_ne_Kosove_Prill_2012_Prishtine_faqe_2).

<sup>6</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës : Kapitulli III Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre , (Neni 57 Parimet e Përgjithshme ) Gushtë 01 Prishtinë, faqe 18.

<sup>7</sup>[http://www.evropaelire.org/content/article/24684903.html\(Shtohen\\_rastet\\_e\\_shkeljes\\_se\\_te\\_drejtave\\_te\\_njeriut\)\\_E\\_merkurë\\_gusht\\_14\\_2013\\_Kosova\\_07:44\\_Prishtinë](http://www.evropaelire.org/content/article/24684903.html(Shtohen_rastet_e_shkeljes_se_te_drejtave_te_njeriut)_E_merkurë_gusht_14_2013_Kosova_07:44_Prishtinë).

<sup>8</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012\\_hrr\\_kos\\_alb\\_raporti\\_i\\_vitit\\_2012\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_ne\\_Kosove\\_Prill\\_2012\\_Prishtine\\_faqe\\_27](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012_hrr_kos_alb_raporti_i_vitit_2012_mbi_te_drejtat_e_njeriut_ne_Kosove_Prill_2012_Prishtine_faqe_27).

<sup>9</sup>( Neni 27 Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizer, Çnjërzor ose Poshtëruës Kushtetuta e Republikës së Kosovës 01 )Gushtë Prishtinë faqe 8.

<sup>10</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012\\_hrr\\_kos\\_alb\\_raporti\\_i\\_vitit\\_2012\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_ne\\_Kosove\\_Prill\\_2012\\_Prishtine\\_faqe\\_2](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012_hrr_kos_alb_raporti_i_vitit_2012_mbi_te_drejtat_e_njeriut_ne_Kosove_Prill_2012_Prishtine_faqe_2).

Një shqetësim tjetër mbetet kërcënimi ndaj mediave nga zyrtarët publikë, pavarësisht se Kushtetuta garanton lirinë e mediave.<sup>11</sup> Megjithatë, pati raportime që përfaqësuesit e mediave janë kërcënuar nga zyrtarët publikë, politikanët dhe bizneset.<sup>12</sup> Në problemet dhe abuzimet që raportohen në Kosovë në fushën e të drejtave të njeriut janë: korrupsioni në Qeveri, përparimi i kufizuar në kthimin e personave të zhvendosur brenda vendit (PSHBV). Sipas Qendrës për monitorim të zhvendosjes brenda vendit, një numër i madh i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve mbetën të paregjistruar, një pjesë e tyre jetojnë në vendbanime joformale të cilave u mungon rryma dhe shërbimet e tjera themelore.<sup>13</sup>

Puna e fëmijës në sektorin joformal është problem. Sipas UNICEF-it, numri i fëmijëve që kërkojnë lëmshë në rrugët e qyteteve dhe qytezave shënoi rritje viteve të fundit, ndonëse numri i përgjithshëm i fëmijëve lypës mbetet i panjohur.<sup>14</sup> Poashtu Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së Hagës të vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.<sup>15</sup>

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminim e bazuar në orientim seksual, megjithatë pati raportime për dhunë dhe diskriminim të lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, përikishtë në muajin Janar kur për herë të parë u botua Revista 02 në Kosovë.<sup>16</sup> Sa i përket kushteve të pranueshme të punës në Republikën e Kosovës, punëtorëve u shkelet e drejta e tyre, kjo sepse punëdhënësit shpesh nuk i respektojnë standardet zyrtare të punës për shkak të mungesës së detyrimit nga ana e Qeverisë. Punëtorët shpesh nuk i raportojnë shkeljet e tilla për shkak të frikës nga reprezaljet. Sipas BSPK-së, shumë individë punojnë më orar të gjatë në sektorin privat pa kontribute pensionale.<sup>17</sup>

---

<sup>11</sup>Neni 42 Liria e Medieve Gushte 01 , 2013 Prishtinë.

<sup>12</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012\\_hrr\\_kos\\_alb\\_raporti\\_i\\_vitit\\_2012\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_ne\\_Kosove\\_ , Prill 2012 Prishtinë , faqe 11.](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012_hrr_kos_alb_raporti_i_vitit_2012_mbi_te_drejtat_e_njeriut_ne_Kosove_ , Prill 2012 Prishtinë , faqe 11.)

<sup>13</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_RAPORTI\\_MBI\\_TE\\_DREJTAT\\_E\\_NJERIUT\\_NE\\_KOSOVE\\_ , Prille 2012 Prishtine. faqe 15 .](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti_mbi_te_drejtat_e_njeriut_RAPORTI_MBI_TE_DREJTAT_E_NJERIUT_NE_KOSOVE_ , Prille 2012 Prishtine. faqe 15 .)

<sup>14</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_RAPORTI\\_MBI\\_TE\\_DREJTAT\\_E\\_NJERIUT\\_NE\\_KOSOVE\\_ , Prille 2012 Prishtinë. faqe 15 .23.](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti_mbi_te_drejtat_e_njeriut_RAPORTI_MBI_TE_DREJTAT_E_NJERIUT_NE_KOSOVE_ , Prille 2012 Prishtinë. faqe 15 .23.)

<sup>15</sup>[http://travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport\\_4308.html.](http://travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport_4308.html.)

<sup>16</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_2012.pdf](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti_mbi_te_drejtat_e_njeriut_2012.pdf) Prishtinë faqe 30.

<sup>17</sup>[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_2012.pdf](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti_mbi_te_drejtat_e_njeriut_2012.pdf) Prishtinë faqe 33.

### **III. Raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Kosovë**

Pjesa e parë e hulumtimit njoftoi se cilat të drejta u shkelen me shumë qytetarëve të Kosovës, ndërsa pjesa e dyte e hulumtimit pasqyron raportet e organizatave ndërkombëtare dhe vendore për respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Në raportet e dy Organizatave ndërkombëtare, “Human Rights Watch” dhe “FreedomHouse”, Kosova renditet si i vetmi vend jo i lire në Evropë. Mosndëshkimi i shkaktarëve të trazirave të marsit të vitit 2004, trafikimi i qenieve njerëzore, dhjetëra mijëra procese gjyqësore të papërfunduara, që qëndrojnë me vite në sirtarët e gjykatave dhe korrupsioni i instaluar në të gjitha mekanizmat e vendit, janë vetëm disa nga faktorët dhe fushat ku shënohen shkelje të të drejtave të njeriut në Kosovë sipas raportit të dy organizatave.<sup>18</sup>

Mbrojtja e të drejtave të njeriut në Ballkanin Perëndimor nuk përputhet me aspiratat e rajonit për t’u integruar në BE, thuhet në raportin e Human Rights Watch për vitin 2013. Sipas këtij raporti, Kosova ka bërë pak progres kundër diskriminimit dhe abuzimeve ndaj pakicës rome apo në gjetjen e zgjidhjeve afatgjata për t’iu përgjigjur nevojave të të shpërngulurve.<sup>19</sup>

Amensty International në anën tjetër shpreh shqetësim për faktin që në marrëveshjen mes Kosovës dhe Serbisë, nuk janë marrë parasysh të drejtat e njeriut. Nuk mund të kemi një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë dhe të flasim vetëm për një kufi”.<sup>20</sup>

Ndërsa Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, vlerëson se Kosova aktualisht nuk është një ambient i përshtatshëm për të shënuar përparim në realizimin e të drejtave të njeriut. Kosova, me një ambient ku afër 70 për qind janë të varfër, me një papunësi prej 60 për qind, me një mungesë të programeve zhvillimore, me një kufizim të lirisë së lëvizjes për shkak të

---

<sup>18</sup><http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2013/kosovo> (22 Maj 2013).

<sup>19</sup><http://www.zeriamerikes.com/content/raporti-amnesty-international/1666461.html> (23 Maj 2013).

<sup>20</sup><http://www.zeriamerikes.com/content/raporti-amnesty-international/1666461.html> (23 Maj 2013).

vizave, nuk është një ambient i përshtatshëm ku mund të flitet për përparimin e shpejtë të të drejtave të njeriut.<sup>21</sup>

Organizata për Demokraci Antikorrupsion dhe Dinjitet “Çohu”, vlerëson se në Kosovë, më shumë se shkelje të drejtëpërdrejtë të të drejtave individuale, ka shkelje të të drejtave sociale dhe grupore të njerëzve. Kjo për faktin se të gjitha politikat sidomos në fushën e ekonomisë, deri më sot kanë injoruar problemin kryesor që e ka Kosova, problemin e varfërisë. Diskriminimet më të mëdha të njerëzve sipas kësaj organizate kanë ndodhur në sektorin publik .

#### **IV. Përfundimi**

Kosova si shteti i ri, me aspirata të mëdha duhet të bëjë më shumë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nuk mjaftojnë vetëm dispozitat ligjore kushtetuese, por ato duhet të plotësohen dhe realizohen me veprime faktike në terren. Realiteti në letër dhe realiteti në praktikë janë dy realitete të ndryshme. Shteti duhet të luaj një rol më pro aktiv në promovimin dhe trajtimin e barabartë, dhe po ashtu në ngritjen e vetëdijes tek zyrtaret publik dhe zbatuesit e ligjit mbi përgjegjësinë që e kanë ata mbi implementimin e legjislacionit në fuqi. Prandaj, është e domosdoshme forcimi i mekanizmave institucionale, në mënyrë që të garantohen të drejtat dhe liritë për të gjithë qytetarët dhe kështu të sigurohet edhe bashkëjetesa paqësore në vend.

---

<sup>21</sup><http://www.koha.net/> maj 2013, Prishtine.

## Bibliografia:

Deklarata Univerzale për të drejtat e njeriut Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 217 A (III) të datës 10 dhjetor ( 1948): NewYork Human RightsSupportProgramme.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe politike : Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 2200A ( XXI ) , të datës 16 dhjetor ( 1996) NewYork: Human RightsSupport Programe.

Të drejtat e njeriut, marrëdhëniet etnike dhe demokracia në Kosovë. Verë- 2007 - 2008.<http://www.osce.org/sq/kosovo/33283> Prishtinë.

[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012\\_hrr\\_kos\\_alb\\_raporti\\_i\\_vitit\\_2012\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_ne\\_Kosove,\\_Prill\\_2012\\_Prishtine\\_](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/2012_hrr_kos_alb_raporti_i_vitit_2012_mbi_te_drejtat_e_njeriut_ne_Kosove,_Prill_2012_Prishtine_)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës :Kapitulli III Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre , Neni 57 Parimet e Përgjithshme .01 Gushte, 2013 Prishtinë.

[.http://www.evropaelire.org/content/article/24684903.html](http://www.evropaelire.org/content/article/24684903.html)( Shtohen rastet e shkeljes se te drejtave te njeriut )E mërkurë, gusht 14, 2013 Kosova 07:44 Prishtine.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës :Neni 27 Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar 01 Gushte , 2013 Prishtinë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës :Neni 42 Liria e Medieve, 01 Gushte, 2013 Prishtinë.

[http://travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport\\_4308.html](http://travel.state.gov/abduction/resources/congressreport/congressreport_4308.html).

[http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti\\_mbi\\_te\\_drejtat\\_e\\_njeriut\\_2012.pdf](http://photos.state.gov/libraries/kosovo/231771/PDFs/Raporti_mbi_te_drejtat_e_njeriut_2012.pdf)

<http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2013/kosovo>

<http://www.zeriamerikes.com/content/raporti-amnesty-international/1666461.html> 23 Maj 2013.

<http://www.koha.net/> maj 2013 , Prishtinë.